

AMICUS CURIAE

OPINION

RRETH MUNDËSISË SË RISHIKIMIT TË VENDIMEVE PENALE PËRFUNDIMTARE PAS KONSTATIMIT NGA GJYKATA EUROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT TË SHKELJEVE TË PROCESIT TË DREJTË NË ÇËSHTJEN LASKA DHE LIKA

(Ankimi nr. 12315/04 dhe 17605/04)

Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Soros dhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit me qëllim për t'i ardhur sadopak në ndihmë Gjykatës së Lartë për shqyrtimin e kërkesës së bërë nga dy ankuesit Lika dhe Laska për rishikimin e vendimit të tyre final Kërkesa me nr. V-110, datë 19.11.2010 ju paraqesim këtë opinion ligjor rreth mundësive juridike që ofron sistemi ligjor shqiptar për rihapjen e procesit penal të përfunduar, pas konstatimit nga GJEDNJ të shkeljeve të procesit të drejtë të parashikuar nga neni 6 § 1 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Sikurse është bërë e njohur, me vendimin e datës 20 Prill 2010 GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me mënyrën arbitrare të marrjes dhe të vlerësimit të provës vendimtare të fajësisë së tyre – paraqitjes për njohje dhe dëshmime okulare. Në paragrafët 73 – 77 të vendimit, Gjykata shprehet për marrjen e masave për ndreqjen e shkeljeve dhe rivendosjen e së drejtës së aplikantëve, në zbatim të nenit 46 të Konventës. Në mënyrë specifike Gjykata shprehet se :

“Në çështjen në fjalë, Gjykata gjeti se e drejta e aplikantëve për një gjyq të drejtë ishte shkelur seriozisht nga autoritetet vendase” dhe se, për këtë arsye, ajo “gjykon se, në çështjen në fjalë, një rigjykim ose rihapje e çështjes, nëse do të kërkohej nga aplikanti, përfaqëson në parim një mënyrë të përshtatshme të korrigjimit të shkeljes. Kjo është në përputhje me udhëzimet e Komitetit të Ministrave, të cilat në Rekomandimin Nr. R (2000) 2 u bënin thirrje Shteteve Palë të Konventës që të prezantojnë mekanizma për rishqyrtim të çështjes dhe rihapje të procedimeve në nivel kombëtar, duke konstatuar se masa të tilla përfaqësojnë “mjetin më të efektshëm, në mos të vetmin mjet, për të arritur *restitutio in integrum*”¹.

Siç e konstaton dhe GJEDNJ, sistemi penal shqiptar nuk lejon (nga pikëpamja formale) një rishikim të vendimeve penale përfundimtare nëpërmjet rihapjes së procesit, pas konstatimit nga GJEDNJ të shkeljeve serioze të procesit të drejtë. Siç është formuluar neni 450 i Kodit të Procedurës Penale:

¹ Vendimi i Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut në çështjen Lika dhe Laska , paragrafi 74-75.

1. Rishikimi mund të kërkohet:

a) kur faktet e vëna në themel të vendimit nuk pajtohen me ato të një vendimi tjetër të formës së prerë;

b) kur vendimi është bazuar në një vendim të gjykatës civile, i cili është revokuar më pas;

c) kur pas vendimit kanë dalë ose janë zbuluar prova të reja, të cilat vetëm ose së bashku me ato që janë vlerësuar njëherë, tregojnë se vendimi është i gabuar;

ç) kur vërtetohet se vendimi është dhënë si pasojë e falsifikimit të akteve të gjykimit ose të një fakti tjetër të parashikuar nga ligji si vepër penale.

Hipotezat e nenit 450 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) nuk parashikojnë shprehimisht një mundësi të tillë, por gjithashtu duhet të theksohet se as nuk e përjashton shprehimisht, ashtu siç e parashikon neni 494, pika “ë” i Kodit të Procedurës Civile (KPC) ose neni 42, pika “ç” i Ligjit Nr. 10193, datë 03.12.2009 “Për Marrëdhëniet Juridiksionale me Autoritetet e Huaja në Çështjet Penale” për efekte të ekstradimit. Për më tepër, marrja e një mase të përgjithshme legjislative në plotësim të KPP, siç e kërkon neni 46 i Konventës dhe vetë Gjykata në vendimin e saj, në analogji me dispozitën përkatëse të KPC, aktualisht është e pamundur për shkak të bllokimit politik ndërmjet dy partive më të mëdha politike në Parlament, gjë e cila në fakt ka penguar miratimin e ligjeve të rëndësishme që kërkojnë shumicë të cilësuar të votave të anëtarëve të Parlamentit, sikurse janë Kodet.

Fakti që efekti i vendimit të GJEDNJ, në çështjen në fjalë, nuk mund të jetë i shpejtë bie në kundërshtim me praktikën e Strasburgut dhe kërkon veprimin e gjykatës shqiptare për të mënjeluar ose plotësuar vakumin ligjor. Në vendimin Vermeire kundër Belgjikës, Gjykata është shprehur se: “Liria e zgjedhjes e lejuar një shteti lidhur me mënyrat e përmbushjes së detyrimeve të tij që burojnë nga Neni 53 (neni 53) nuk i japin atij të drejtën të pezullojë zbatimin e Konventës deri në përfundimin e një reforme”². Në mënyrë të ngjashme, duhet të vihet në dukje se sipas Rekomandimit REC (2004)5 të Këshillit të Ministrave për shtetet anëtare “*Mbi verifikimin e përputhshmërisë së projektligjeve, ligjeve ekzistuese dhe praktikave administrative me standartet e përcaktuara në Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut*”, një verifikim i tillë mund të bëhet gjithashtu...”brenda kornizës së procedurave gjyqësore të sjella nga individë me të drejtë ligjore për të vepruar apo edhe nga institucione shtetërore, individë apo organe jo të prekur në mënyrë të drejtpërdrejtë (p.sh., përpara Gjykatës Kushtetuese)”³. Për më tepër, autorët e këtij parashtrimi nuk mundet të mos theksojnë vendimin novator të Gjykatës Kushtetuese Shqiptare lidhur me kushtetueshmërinë e dënimit me vdekje, ku megjithë mungesën e një parashikimi të qartë ligjor mbi paligjshmërinë e këtij dënimi dhe megjithë faktin që Protokollin përkatës në Konventë nuk ishte ratifikuar nga Shqipëria, Gjykata Kushtetuese deklaroi se dënimi me vdekje binte në kundërshtim me Kushtetutën e Shqipërisë dhe jo vetëm i kërkoi legjislativit të merrte masat e nevojshme për ta hequr zyrtarisht këtë dënim, por dhe e shpalli atë si të

² Ankimi nr. 12849/87, paragrafi 26.

³ Paragrafi 28.

“Pazbatueshëm” në pritje të miratimit të legjislacionit⁴. Jemi të mendimit se qasja interpretuese e përdorur nga Gjykata Kushtetuese në atë rast duhet të përdoret sërish nga Gjykata për të konsideruar kërkesën e Z. Laska dhe Lika për rihapjen e procedimit.

Pra, si për shkak të detyrimit që shteti ka në bazë të nenit 46 të Konventës ashtu dhe sipas parimit të përcaktuar në *vendimin Vermeire*, Gjykata e Lartë duhet të eksplorojë mundësitë që ofron sistemi juridik shqiptar për të gjetur një zgjidhje të përshtatshme, me qëllim që të drejtat e të dënuarve Laska e Lika të realizohen në praktikë në përputhje me parimet e drejtësisë. Në këtë kontekst, ne mendojmë se sistemi legal shqiptar ofron disa mundësi, të cilat mund të përdoren si argumente kumulative.

I

Zbatimi i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe i Kushtetutës të Shqipërisë në plotësim të vakumeve të sistemit normativ shqiptar

Sipas Kushtetutës së Shqipërisë, nenet 116 e 122/1, Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut ka epërsi mbi ligjet, si të zakonshme ashtu dhe ato të cilësuar dhe është direkt e zbatueshme nga gjykatat shqiptare. Ky fakt përforcohet më shumë edhe nga formulimet analoge të të drejtave dhe lirive të individit të parashikuara në Konventën Europiane dhe në Kushtetutë. Veç kësaj, neni 17/2 i Kushtetutës e konstitucionalizon shprehimisht statusin e kufizimeve të të drejtave të parashikuara nga Konventa, pra, të drejtat që burojnë nga procesi i drejtë nuk mund të kufizohen përtej caqeve të caktuara në Konventë dhe në praktikën e GJEDNJ.

Është e vërtetë se neni 6 § 1 i Konventës nuk parashikon të drejtën e rihapjes së proceseve gjyqësore që kanë përfunduar me vendim të formës së prerë dhe, prandaj, gjykata shqiptare nuk mund të procedojë direkt mbi bazën e këtij neni, por, nga ana tjetër ajo është e detyruar sipas nenit 46 të Konventës që, në mungesë të ligjit, të krijojë mjetin juridik për rishikimin e vendimeve përfundimtare për të bërë të mundur ekzekutimin e vendimeve të Strasburgut dhe realizimin praktik të të drejtave të ftuara nga individët në Gjykatën Europiane. Si vijim, parimit se gjykata nuk mund të refuzojë të japë drejtësi për shkak se ligji mungon i duhet dhënë një kuptim më i gjerë, duke mbuluar dhe rastet e rishikimit të vendimeve përfundimtare pas konstatimit nga GJEDNJ të shkeljeve të procesit të drejtë. Ky detyrim buron drejtpërsëdrejti nga Konventa dhe shërben si bazë për të krijuar mjetin juridik të përshtatshëm për t’iu përgjigjur situatës problematike. Duhet gjithashtu të vihet në dukje që Shteti Shqiptar nuk e sfidon domosdoshmërinë e ndryshimit të Kodit të Procedurës Penale në mënyrë që të lejojë rihapjen e procesit pas një vendimi të Gjykatës, për këtë qëllim - në fakt Qeveria shqiptare ka informuar

⁴ Shih vendimin Nr. 65, 10/12/1999.

Këshillin e Ministrave të Këshillit të Europës se ajo planifikon të prezantojë këtë ndryshim të nevojshëm në fillim të vitit 2012⁵.

Nga fakti se të drejtat dhe liritë individuale në Kushtetutën shqiptare dhe në Konventën Europiane janë analoge dhe se kufizimet e të drejtave e lirive kanë status kushtetues, del se çdo shkelje e Konventës Europiane është njëkohësisht edhe shkelje e Kushtetutës. Për rrjedhojë, korrigjimi i shkeljeve konventore do të thotë njëkohësisht edhe korrigjim i shkeljeve të Kushtetutës. Në lidhje me vendimin e GJEDNJ, *Barbera etj kundër Spanjës*⁶, Gjykata Kushtetuese spanjolle, në mungesë të ligjit të shprehur, vendosi rishikimin e vendimit përfundimtar me efekt *res judicata* me argumentin se lënia në fuqi e një vendimi me shkelje të rënda procedurale ishte në kundërshtim me rendin kushtetues⁷. Në mënyrë të ngjashme, GJEDNJ (në dy vendimet e saj të vitit 2004 *Maestri kundër Italisë dhe Asanidze kundër Gjeorgjisë*) dhe Këshilli i Ministrave (në Rekomandimin e tij 6/2004 *Për përmirësimin e mjeteve të brendshme të ankimit*) përcaktuan se shtetet ishin të detyruara të modifikonin të drejtën e tyre të brendshme për t'u dhënë fund shkeljeve të Konventës dhe për të ekzekutuar vendimet e GJEDNJ. Modifikimi i së drejtës së brendshme nënkupton edhe krijimin e mjetit juridik nga gjykatat, në mungesë të ligjit të shprehur. Për të ilustruar këtë çështje, kohët e fundit, pas vendimit të Gjykatës në çështjen *Brusco kundër Francës* (ankimi nr. 1466/07, Vendimi i datës 14 tetor 2010) ku mohimi i së drejtës për t'u patur kontakt me një avokat gjatë orëve të para të paraburgimit dhe kërkesa për të pandehurit për t'u betuar para dhënies së dëshmisë u konsideruan shkelje të nenit 6, Asambleja Plenare e Gjykatës së Lartë Franceze vendosi t'i japë efekt të menjëhershëm Vendimit të Gjykatës lidhur me te drejtën për të patur kontakt të menjëherëm me një avokat, megjithëse legjislacioni përkatës, nuk ishte amenduar ende. Duke i bërë jehonë vendimit të Gjykatës Kushtetuese Spanjolle *Barbera et al kundër Spanjës*, Asambleja konsideroi që «Shtetet

⁵ Shih planin e veprimit të Qeverisë Shqiptare dorëzuar Këshillit të Ministrave të Këshillit të Europës lidhur me çështjet *Berhani vs. Albania*, nr. vendimi 847/05 i aksesueshëm në faqen e internetit [http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/execution/Source/Documents/Info_cases/Albanie/DD\(2011\)314 .pdf](http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/execution/Source/Documents/Info_cases/Albanie/DD(2011)314.pdf) paragraph 8, *Caka vs. Albania*, nr. kërkesë 44023/02, mund ta gjeni në : [http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/execution/Source/Documents/Info_cases/Albanie/DD\(2011\)313.pdf](http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/execution/Source/Documents/Info_cases/Albanie/DD(2011)313.pdf) , paragrafi 7 dhe *Xheraj vs. Albania*, nr. kërkesë 37959/02, mund ta gjeni në [http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/execution/Source/Documents/Info_cases/Albanie/DD\(2011\)131rev.pdf](http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/execution/Source/Documents/Info_cases/Albanie/DD(2011)131rev.pdf) paragrafi 15. Në tre dorëzimet, Qeveria Shqiptare është shprehur se: "Autoritetet shqiptare kanë ndermarrë nismën për ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale në mënyrë që të parashikojnë se gjykimet e GJEDNJ që kanë konstatuar shkelje përbëjnë një bazë ligjore për shqyrtimin e vendimeve përfundimtare të gjykatave vendase. Ministria Shqiptare e Drejtësisë është autoriteti përgjegjës për draftimin e këtyre amendamenteve. Më tej, Këshilli i Ministrave duhet t'i miratojë këtë ndryshim (në tremujorin e fundit të vitit 2011). Pas kësaj amendamenteve duhet të miratohen nga Kuvendi në mënyrë që të marrin fuqinë e Ligjit.

⁶ Ankimi nr. 10590/83.

⁷ Shih dokumentin e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës i titulluar "*Shembuj të kërkesave për rihapjen e procedimeve me synim për t'i dhënë efekt vendimeve të Gjykatës Europiane e të Drejtave të Njeriut dhe Komitetit të Ministrave*", Rekomandimi (99)10 i rishikuar i aksesueshëm në faqen e http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/execution/Documents/Reopening_en.asp faqja 3.

që aderojnë në Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut janë të detyruar të respektojnë vendimet e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, pa pritur të jenë ndëshkuar nga kjo Gjykatë më parë ose të kenë ndryshuar legjislacionin e tyre”⁸.

Sipas nenit 44 të Kushtetutës: “Kushdo ka të drejtë të rehabilitohet dhe/ose të zhdëmtohet në përputhje me ligjin, në rast se është dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore”. Meqenëse organet e pushtetit publik kanë për detyrë të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre (neni 15/2 i Kushtetutës), si dhe meqë e drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit (neni 4 i Kushtetutës), gabimet gjyqësore që çojnë në shkeljen e këtyre të drejtave nuk mund të lihen në fuqi në një rend kushtetues demokratik dhe për këtë arsye, parimi *res judicata* nuk mund të veprojë.

Shteti shqiptar, sipas nenit 5 të Kushtetutës, zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të. Në këtë kontekst, Konventa e Vjenës për respektimin, zbatimin dhe interpretimin e marrëveshjeve ndërkombëtare (siç është dhe KEDNJ) detyron shtetet palë t’i zbatojnë ato me ndërgjegje dhe se: “Një palë nuk mund të përdorë dispozitat e së drejtës së brendshme si justifikim për pamundësinë e tij për të zbatuar një traktat” (Neni 27). Në këtë kuptim, gjykatat duhet të respektojnë normat e Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, i cili është pjesë e sistemit normativ shqiptar (aderuar me Ligjin Nr. 7510, datë 08.08.1991). Në nenin 14, paragrafi 1 i seksionit 6 të këtij Pakti parashikohet se një vendim penal përfundimtar mund të rishikohet në qoftë se ndonjë rrethanë e re ose e zbuluar rishtas provon se është bërë një gabim gjyqësor. Vërtet Pakti nuk detyron formalisht shtetet palë të vendosin norma për rishikimin e vendimeve penale përfundimtare, por ai parashikon një element të rëndësishëm që përbën shkak për rishikim: **rrethanën e re krahas rrethanës së zbuluar rishtazi**, duke bërë dallimin ndërmjet **fakteve të ndodhura para marrjes së vendimit përfundimtar** (siç parashikojnë neni 450/c i KPP dhe neni 494/a i KPC) dhe **fakteve të ndodhura pas marrjes së tij**. Një rrethanë e re e krijuar *a posteriori* dhe që provon gabimin gjyqësor është pa dyshim vendimi i GJEDNJ që konstaton shkeljen e Konventës (shih seksionin IV të këtij Opinioni).

Zbatimi i nenit 494/ë të KPC me analogji në procedurën penale

Meqenëse gjyqtari nuk mund të refuzojë të japë drejtësi me pretekstin se mungon ligji ose dispozita përkatëse, atëherë ai është i detyruar ta kapërcejë ose ta mbushë vakumin ligjor me anë të zbatimit të analogjisë (parimi i zbatimit subsidiar të ligjit). Në rastin konkret, sfera ku ajo aplikohet është procesi gjyqësor, i cili nga natyra e vet si në fushën civile ashtu dhe penale paraqet karakteristika të ngjashme: aspekti i mbrojtjes së të drejtave individuale është evident,

⁸ Deklarata për Shtyp e Gjykatës së Lartë Franceze, 15 prill 2011, mund ta gjeni në frëngjisht në faqen http://www.courdecassation.fr/jurisprudence_2/assemblee_pleniere_22/589_15_19792.html

çështja kërkon rregullim juridik dhe ky rregullim është i parashikuar në nenin 494/ë të KPC. Analogjia është e plotë sepse bëhet fjalë për të njëjtin institut procedural – rishikimin e vendimeve gjyqësore përfundimtare. Zbatimi i nenit 494/ë të KPC me analogji synon zgjerimin e të drejtave të individëve në procesin penal dhe nuk mund të konsiderohet si rrezik për rendin publik dhe drejtësinë. Përkundrazi, nevojat e drejtësisë kërkojnë që shkeljet e vërtetuara nga GJEDNJ të riparohen dhe që asnjë vendim të mos veprojë në kundërshtim me rendin kushtetues. Parimi i *res judicata* nuk është absolut në kuptimin se ai nuk mund të barazohet ose të rrjedhë nga maksima *fiat justitia pereat mundus*. Në rast të kundërt, vendimet e Gjykatës Europiane do të mbeteshin pa efektin e duhur dhe do të ktheheshin në mjete juridike iluzionare, kurse të drejtat e individit do të mbeteshin në letër.

Në sfondin e kësaj analogjie del se, mosveprimi i gjykatës për shkak të mungesave në nenin 450 të KPP për të rishikuar vendimet përfundimtare pas konstatimit të shkeljeve të procesit të drejtë nga GJEDNJ shkel parimin e barazisë së individëve para ligjit dhe gjykatës. Individët nuk mund të kenë status të diskriminuar në procesin penal në krahasim me procesin civil. Kur në këtë të fundit lejohet rishikimi i vendimeve me efekt *res judicata*, ku shpesh në procese të tilla preken interesa të personave të tretë që nuk kanë patur mundësi mbrojtjeje, aq më tepër që në procesin penal duhet lejuar rishikimi i vendimeve gjyqësore përfundimtare pasi individët rrezikojnë vlera dhe interesa shumë më të rëndësishme.

III

Interpretimi i praktikës së Gjykatës Kushtetuese

Një mënyrë praktike për të mënjeluar vakumin në nenin 450 të KPP, lidhur me mundësinë e rishikimit të vendimeve penale përfundimtare pas konstatimit nga GJEDNJ të shkeljeve të procesit të drejtë, vjen në ndihmë interpretimi i jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese lidhur me kontrollin mbi çështjet gjyqësore në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës. Prej vitesh, Gjykata Kushtetuese ushtron kontrollin konkret kushtetues mbi vendimet e gjyqësorit që kanë marrë formë përfundimtare në Gjykatën e Lartë, duke i kthyer çështjet për rigjykim.

Sipas Kushtetutës (neni 135) pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, si dhe nga gjykatat e apelit e gjykatat e shkallës së parë. Gjykata Kushtetuese, megjithëse është organ që ushtron funksione gjyqësore, ajo e bën këtë nga pikëpamja e parimeve dhe kritereve specifike kushtetuese dhe nuk përfshihet në sistemin gjyqësor të zakonshëm. Ky fakt do të thotë se ajo nuk është instancë e katërt në procedimet gjyqësore dhe, për rrjedhojë, vendimet gjyqësore të gjykatave të zakonshme e marrin formën përfundimtare brenda këtij sistemi (sipas rastit, në shkallë të parë kur nuk ka ankim, në apel pas apelit ose në Gjykatën e Lartë pas rekursit). Këtij kuptimi i shërben edhe rregulli i shterimit të të gjitha mjeteve juridike, sipas nenit 131/f të Kushtetutës. Në disa vendime, Gjykata Kushtetuese është shprehur qartë se detyra e saj: “... nuk është zgjidhja e një çështjeje konkrete, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese...” dhe se

ajo “mund të vlerësojë mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit që, në parim, u takon gjykatave të sistemit të zakonshëm, vetëm nëse përmes këtij procesi janë cënuar të drejtat kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor”, sepse : “...kontrolli i ushtruar nga kjo Gjykatë...është një kontroll subsidiar”⁹. Në një vendim të hershëm, Gjykata Kushtetuese është shprehur qartësisht se: “...bëhen objekt gjykimi në Gjykatën Kushtetuese edhe ato çështje gjyqësore të paraqitura nga individët për shkeljen e të drejtave të tyre pasi vendimi i gjykatës ka marrë formë të prerë dhe nuk ekzistojnë më mjete dhe rrugë ligjore për mbrojtjen e këtyre të drejtave”. Në këtë mënyrë ajo e ka vendosur veten në pozicionin e një gjykate, vendimi i së cilës është shkak për rishikimin e vendimeve penale përfundimtare.

Vetë shfuqizimi i vendimeve gjyqësore përfundimtare nga Gjykata Kushtetuese është një konfirmim i faktit të rishikimit të tyre në rastin e procesit të drejtë. Gjykata e Lartë ka gjykuar shumë raste të tilla pas kthimit të çështjes nga Gjykata Kushtetuese. Në qoftë se Gjykata Kushtetuese mund të rishikojë konstitucionalisht vendimet përfundimtare të gjyqësorit mbi bazën e parimeve të Kushtetutës dhe të jurisprudencës së së Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (që në sferën e të drejtave të njeriut janë pothuajse identike), Gjykata e Lartë nuk ka asnjë pengesë juridike ta rishikojë çështjen në themel. Parimet kushtetuese dhe jurisprudenca e Strasburgut janë njëlloj të vlefshme e të detyrueshme për Gjykatën e Lartë. Nëse kjo Gjykatë rishikon vendime përfundimtare penale pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, atëherë ajo duhet të rishikojë vendime të tilla edhe pas vendimit të Gjykatës Europiane. Praktika kushtetuese e ka krijuar mjetin juridik për këtë qëllim; mbetet që atë ta ushtrojë Gjykata e Lartë. Nuk është as efikase e as e përligjur nga pikëpamja e mbrojtjes së të drejtave të njeriut që, pas vendimit të Gjykatës së Strasburgut, individët t’i drejtohen Gjykatës Kushtetuese dhe vetëm pas kësaj çështja t’i referohet Gjykatës së Lartë për rishikim. Për më tepër, vetëm gjykatat e sistemit të zakonshëm gjyqësor kanë kompetencë të vendosin përfundimisht mbi çështjen e rishikuar. Lidhur me këtë, Gjykata Kushtetuese gjermane, duke rrëzuar vendimin e Gjykatës së Lartë Rajonale të Naumburgut, e cila argumentonte se vendimet e GJEDNJ janë të detyrueshme vetëm për RFGJ si subjekt të së drejtës ndërkombëtare publike dhe jo për gjykatat, u shpreh se vendimet e Gjykatës Europiane detyronin gjithashtu dhe gjykatat gjermane.

Në një vendim të saj Nr. 21, datë 29.04.2010, Gjykata Kushtetuese ka vendosur shfuqizimin e vendimit Nr. 14 datë 03.10.2008 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë si antikushtetues dhe dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë. Në arsyetimin e saj Gjykata Kushtetuese shprehet se: “Pretendimin e kërkuarit për të qenë i pranishëm në seancë, Gjykata... e lidh... me mundësinë që i duhet dhënë palëve për t’iu respektuar të drejtën për rigjykim...” (paragrafi 21). Fakti është se kjo çështje ka të bëjë me gjykimin në mungesë dhe me të drejtën e të dënuarit për t’u rigjykuar pas ekstradimit pas një vendimi përfundimtar fajësie. Në të vërtetë, rigjykimi këtu është rrjedhojë direkte e Konventës Europiane për Ekstradimet dhe

⁹ Vendimi nr.16, date 16.04.2010, paragrafi 1, Vendimi nr.36, date 10.11.2010

çështja këtu ka të bëjë me zbatueshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare, të cilat në mungesë të ligjit vendas¹⁰ sipas nenit 122 të Kushtetutës, kanë status mbiligjor. Ligji shqiptar Nr 10193, datë 03.12.2009 “Për Marrëdhëniet Juridiksionale me Autoritetet e Huaja në Çështjet Penale”, sipas të cilit i ekstraduari ka : “të drejtën e rishikimit të vendimit gjyqësor të dhënë ndaj tij.”, ka dalë më vonë se vendimi Nr. 14 datë 03.12.2008 i Kolegjit Penal. Por ajo që ka rëndësi në këtë vendim të Gjykatës Kushtetuese është jo vetëm fakti se krijimi i mjetit juridik për rishikimin e vendimeve penale përfundimtare mund të nxirret nga tërësia e normave të marrëveshjeve ndërkombëtare, në të cilat Shqipëria është palë (pra edhe nga praktika e Konventës Europiane), por edhe se : “...shqyrtimi i ekzistencës ose jo të shkaqeve ligjore për rishikimin e vendimit...[dhe]...interpretimi i konceptit kushtetues të zbatueshmërisë së drejtëpërdrejtë të marrëveshjeve ndërkombëtare...është në vlerësimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë...” (paragrafi 21-22). Gjykatat e një niveli më të ulët, e tillë si Gjykata e Lartë ka miratuar një qasje të tillë dhe bën thirrje për rihapjen e procedimeve penale gjyqësore të përfunduara në ato raste kur është konstatuar shkelja e procesit të rregullt ligjor¹¹.

Një shkak për rishikimin e vendimeve përfundimtare është dhe rasti kur Gjykata Kushtetuese shfuqizon një ligj apo dispozita ligjore, të cilat kanë qenë baza juridike për zgjidhjen e një çështjeje gjyqësore. Ndonëse një klauzolë e tillë nuk figuron në formulën e nenit 450 të KPP, efekti i saj rishikues parashikohet në Ligjin Nr. 8577, datë 10.01.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, në nenin 76/2-a të të cilit njihet fuqia prapavepruese e vendimit të kësaj Gjykate: “ndaj një dënimi penal edhe gjatë kohës që është në ekzekutim, nëse ai lidhet me zbatimin e ligjit ose të aktit normativ të shfuqizuar”. Në këto raste, Gjykata e Lartë është juridikisht e legjitimuar dhe e detyruar të rishikojë vendimin penal përfundimtar, sepse fuqia prapavepruese e vendimit të Gjykatës Kushtetuese nuk mund të realizohet përveçse nëpërmjet rishikimit. Konkluzioni është se rishikimi i këtyre vendimeve nuk mund të bazohet thjesht dhe vetëm në hipotezat e nenit 450 të KPP, por në legjislacionin në tërësi dhe në interpretimin e tij konstruktiv. Nga natyra e vet konstatimi i shkeljes së procesit të drejtë ligjor nga GJEDNJ ka efekt prapaveprues, sepse ndikon mbi vendimet e dhëna nga instancat kombëtare, vetëm se ky efekt duhet të përçohet me anë të mjetit juridik vendas që mund të jetë ligji, vendimi i Gjykatës Kushtetuese ose konceptet interpretuese të Gjykatës së Lartë. Kur ligji mungon duhet të veprojnë drejtësia.

¹⁰ Ligjit Nr. 10193, datë 03.12.2009 “Për Marrëdhëniet Juridiksionale me Autoritetet e Huaja në Çështjet Penale” i cili parashikon se personi i ekstraduar ka: “të drejtën e rishikimit të vendimit gjyqësor të dhënë ndaj tij” është miratuar në një datë të mëvonshme se Vendimi nr. 14, date 03.12.2008 i Kolegjit Penal.

¹¹ Në përputhje me Vendimin nr. 812, datë 17.09.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

IV

Interpretimi i paragrafit “c” të nenit 450 të KPP

Interpretimi i paragrafit “c” të nenit 450 të KPP në termat “kanë dalë” dhe “provë” mund të ishte një mënyrë tjetër për të mbushur vakumin ligjor. Ky paragraf parashikon shkakun e rishikimit: *c) kur pas vendimit kanë dalë ose janë zbuluar prova të reja, të cilat vetëm ose së bashku me ato që janë vlerësuar njëherë, tregojnë se vendimi është i gabuar.* Këtë mënyrë e kemi renditur të fundit sepse e dimë që kuptimi tradicional i “provës së re” në teorinë dhe praktikën juridike shqiptare lidhet me faktet dhe jo me ligjin. Gjithashtu, kuptimi i zakonshëm i dispozitës ka parasysh se këto fakte ose prova duhet të kenë ekzistuar para marrjes së vendimit përfundimtar, por nuk mund të dihen. Megjithatë, duhet të theksohet që neni 450 nuk e ndalon në mënyrë eksplicite interpretimin e tij përgjatë rreshtave në vazhdim

Megjithatë, një lexim i ndryshëm i kësaj dispozite, ashtu siç është formuluar, është i mundshëm. Në të përdoren fjalët “kanë dalë” ose “janë zbuluar” prova të reja. Këto fjalë nuk kanë kuptim të njëjtë: një provë e zbuluar do të thotë se ajo ka ekzistuar para vendimit, por është zbuluar më pas, kurse dalja e një prove të re zakonisht ka kuptimin e një fakti të ndodhur pas marrjes së vendimit. Ky ndryshim kuptimi bazohet në rregullën interpretuese se ligji nuk përdor sinonime, por çdo term ka kuptim juridik specifik. Në qoftë se është kështu, atëherë mbetet për t’u sqaruar nëse provë e re ose fakt i ri është edhe një akt individual zbatimi, siç është vendimi gjyqësor.

Edhe teoria edhe praktika mbajnë pozicionin se një akt, një vendim mund të konsiderohet fakt juridik ose provë në varësi të kontekstit të çështjes. Akti individual i zbatimit mund të paraqitet në rolin e faktit juridik mbi të cilin lindin, ndryshojnë ose shuhen marrëdhënie juridike.

Është e qartë se aktet mund të jenë prova dhe anasjelltas; kjo sidomos kur vendimet gjyqësore kanë karakter prejudicial, d.m.th. kur vendimi penal merret si provë ose fakt në gjykimin civil dhe e kundërta. Në këtë optikë, vendimi i GJEDNJ përbën një provë ose fakt juridik të ri, i cili **ka dalë pas dhënies së vendimit përfundimtar penal** të gjykatës shqiptare. Në të vërtetë, edhe vetë Gjykata ka marrë parasysh se një vendim gjyqësor i ri mund të përbëjë “një fakt të ri”¹². Në qoftë se bëhet ky interpretim, atëherë neni 450/c i KPP është i zbatueshëm

¹² Shih Vendimin *Verein gegen Tierfabriken Schweiz (VgT) kundër Zvicrës (nr. 2)* [GC], kërkesa nr. 32772/02, datë 30 qershor 2009, paragrafi 67: “Megjithatë, nuk mund të thuhet se kompetencat e caktuara Komitetit të Ministrave nga neni 46 i Konventës janë tejkaluar në ato raste kur Gjykatës i duhen informacione të reja në lidhje me një kërkesë të re. Gjithashtu, në rastin konkret Komiteti i Ministrave përmes miratimit të Rezolutës ResDH (2003)125, ka përfunduar mbikqyrjen e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës së datës 28 qershor 2001, megjithëse nuk mori parasysh vendimin e Gjykatës Federale të datës 29 prill 2002 duke i refuzuar kërkesën shoqatës aplikuese për të rihapur procedimet gjyqësore, duke qenë se Qeveria nuk informoi atë lidhur me këtë gjykim”. **Nga ky këndvështrim, refuzimi në themel përbën gjithashtu një fakt të ri. Nëse Gjykata ishte e paaftë të shqyrtonte këtë kërkesë, ajo duhet të mos bënte një shqyrtim të thelluar sipas Konventës”.**

në rastin në fjalë. Ky interpretim pajtohet me nenin 14/6 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, sipas të cilit: “Kur një person më në fund dënohet dhe kur ky dënim penal definitiv anulohet më vonë...për arsye se një **fakt i ri** ose një **fakt i rizbuluar** provon se është bërë një gabim gjyqësor...”. Meqë sipas nenit 122 të Kushtetutës Pakti ka status mbiligjor, ai duhet të zbatohet direkt ose interpretimi i nenit 450/c të KPP duhet të bëhet nga Gjykata e Lartë sipas frymës së tij.

Raste të një interpretimi të tillë nuk mungojnë në praktikën e shteteve palë në Konventë. Kështu, vendimi i Komisionit (në sistemin gjyqësor të Strasburgut para 1998) u konsiderua nga Sllovakia në çështjen Samakova si “fakt i ri” (Raporti 15.01.1997). Po kështu, rishikimi i vendimit të brendshëm të gjykatës daneze pas konstatimit të shkeljes së Konventës në çështjen Jersild k. Danimarkës (vendimi i GJEDNJ 23.09.1994) u bë mbi bazën e nenit 441 të KPP që lejonte rishikim kur ekzistojnë “rrethana të posaçme që tregojnë se ndonjë provë nuk është vlerësuar drejt”. Në çështjen Kerojärvi kundër Finlandës (vendimi i GJEDNJ 19.07.1995) procedura e rishikimit u bazua në interpretimin e Kreut 31 seksioni 1 të Kodit të Procedurës Gjyqësore për shkak të “zbatimit haptazi të padrejtë të ligjit”. Interesante është zgjidhja që iu dha çështjes Van Mehelen k. Holandës (vendimi i GJEDNJ 23.04.1997) legjislacioni i së cilës nuk parashikonte rishikimin e vendimit. Në këtë rast ministri i Drejtësisë urdhëroi lirimin e aplikantëve nga burgu dhe fshirjen e gjendjes gjyqësore. Këto shembuj tregojnë se gjykatat e larta të këtyre shteteve, në mungesë të parashikimeve direkte për rishikimin e vendimeve pas konstatimeve të GJEDNJ, e kanë kapërcyer gjendjen nëpërmjet interpretimit konstruktiv të dispozitave ekzistuese¹³.

Duke interpretuar ligjin e brendshëm lidhur me rishikimin e vendimeve penale përfundimtare, Gjykata e Lartë e Estonisë me vendimin e saj Nr. 3.13.2003, datë 06.01.2004 shprehet: “Gjykata e Lartë *en banc* është e mendimit se madje edhe një interpretim i gjerë i shkaqeve për rishikim dhe ndreqje të gabimeve gjyqësore, të parashikuara në Kodin e Apelit të Gjykatës Penale dhe të Procedurës së Kasacionit, nuk lejon një rigjykim të çështjes penale pas vendimit të GJEDNJ.” Dhe më tej, duke zbatuar direkt Konventën, shprehet se : “ ...rihapja e procedimeve do të justifikohet vetëm në rast të një shkeljeje vazhduese e substanciale dhe vetëm nëse kjo do ta rivendoste statusin juridik të personit. Nevoja për të rihapur procedimin gjyqësor duhet ta kapërcejë sigurinë juridike dhe shkeljen e mundshme të të drejtave të personave të tjerë në rigjykimin e çështjes. Për më tepër, parakusht për rishikimin e një vendimi që ka hyrë në fuqi është që të mos ekzistojnë mjete të tjera efektive për riparimin e shkeljes”.

Në këtë drejtim, duhet gjithashtu të theksohet që si Shteti Shqiptar ashtu edhe Prokuroria e Përgjithshme duket se kanë përqafuar të njëjtën përqsaje interpreuese të përmendur më sipër

¹³ Të gjithë shembujt e përmendur në këtë paragraf janë të aksesueshëm në dokumentin e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës i titulluar “*Shembuj të kërkesave për rihapjen e procedimeve me synim për t'i dhënë efekt vendimeve të Gjykatës Europiane e të Drejtave të Njeriut dhe Komitetit të Ministrave*”, Rekomandimi (99)10 i rishikuar.

lidhur me nenin 450 të K.Pr.P. Siç është cekur në paragrafin 49 të vendimit, të dy entitetet¹⁴ bien dakord se ankuesit mund të paraqesin një kërkesë për rihapjen e procedimeve penale në përputhje me dispozitat e nenit 450 të K.Pr.P¹⁵. Qeveria shqiptare do ta përsëriste argumentimin e saj drejt atij qëllimi në parashtrimin e tyre në çështjen *Shkalla kundër Shqipërisë*¹⁶. Për më tepër në parashtrimin e tyre në Komitetin e Ministrave datë 7 qershor 2011, Qeveria Shqiptare referoi se e ka miratuar atë në vendimin më të fundit të Gjykatës Kushtetuese nr.20, datë 1 qershor 2011 për çështjen Xheraj. Përveç kësaj, për sa kohë që kjo lidhet me institutin e rishikimit të vendimeve penale të formës së prerë, Gjykata Kushtetuese pohon se subjekt i nenit 450/1/a konsiderohen jo vetëm vendimet e dhëna nga gjykatat vendase shqiptare, por gjithashtu vendimet e gjykatave ndërkombëtare të huaja, në përputhje me nenin 10 të Kodit të Procedurës Penale i cili në mënyrë eksplicite i detyron gjykatat të zbatojnë dispozitat e marrëveshjeve ndërkombëtare ku Shqipëria është palë¹⁷. Komiteti i Ministrave e ka përgëzuar këtë veprim të shtetit shqiptar për të marrë masa të menjehershme për të adresuar këtë situatë dhe jo duke pritur ndryshimet përkatëse ligjore¹⁸.

Duke qene se Gjykata i refuzoi këto argumente në të dyja rastet, është me interes të shqyrtohen arsyet e këtij veprimi. Duhet të theksohet që në fillim se Gjykata nuk mori në konsideratë qe kishte diçka në formulimin apo qëllimin e shërbyer nga neni që e bënte atë te paefektshëm në rrethanat e çështjes. Përkundrazi, ajo konsideroi se neni 450 i K.Pr.P skicon një mjet të një natyre të jashtëzakonshme dhe për këtë arsye, sipas nenit 35 të Konventës, ankuesit nuk i kërkohet ta ezaurojë atë përpara dorëzimit të kërkesës së tij/saj në Gjykatë¹⁹. Me fjalë të

¹⁴ Sipas legjislacionit shqiptar, gjykatat duhet të marrin në konsideratë nismat e institucioneve shtetërore. Në çështjen Florian Meçe, vendim i Kolegjeve të Bashkuara nr. 812, datë 17.9.2010, gjykata e bazoi këtë vendim në dy çështje kryesore: a) së pari nisma e Ministrisë së Drejtësisë lidhur me ligjin nr. 10193, datë 03.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale” dhe b) se kërkesa nuk ishte e ndaluar në mënyrë të hapur nga ligji kështu që ajo mund të pranohet nga gjykatat. Me analogji, të dy këto elementë janë të pranishme në çështjen konkrete: si Qeveria shqiptare dhe Prokuroria e Përgjithshme ka shprehur besimin se rihapja e procedimeve gjyqësore nuk është e paligjshme dhe se neni 450 i KPrP mund të interpretohet në këtë kuptim.

¹⁵ Në paragrafin 49 të Vendimit thuhet si vijon: “Në komentet e mëtejshme mbi vëzhgimet e ankuesve, Qeveria dorëzoi një shkresë të Prokurorisë së Përgjithshme të datës 16 prill 2008 ku deklarohet se “në vijim të verifikimeve të dosjes penale hetimore të ankuesit, janë gjetur disa parregullsi procedurale në disa prej veprimeve hetimore”. Në përputhje me letrën e prokurorisë, Qeveria pretendonte se ankuesve duhet t’u kërkohet të kërkonin rishikimin e vendimit përfundimtar në përputhje me nenin 450 të K.Pr.P.

¹⁶ Ankimi nr. 26866/05, Vendimi i 10 maj 2011, paragrafi 55.

¹⁷ Parashtrimi i Qeverisë shqiptare në Komitetin e Ministrave i datës 7.06.2011, numri referues DH-DD(2011)434rev., paragrafi 19.

<https://wcd.coe.int/wcd/com.instranet.InstraServlet?command=com.instranet.CmdBlobGet&InstranetImage=1856839&SecMode=1&DocId=1748336&Usage=2>

¹⁸ Vendim i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës, në mbledhjen e 1115^{te}, të datës 8.6.2011 i aksesueshëm në faqen <https://wcd.coe.int/wcd/ViewDoc.jsp?id=1799029&Site=CM>

¹⁹ Shih p.sh.Vendimin Laska, paragraf 50 - 51: “Gjykata thekson se si rregull i përgjithshëm një kërkesë për rigjykim ose në mënyrë të ngjashme për marrje masash ndreqëse me karakter të jashtëzakonshëm nuk mund të merret në konsideratë për qëllimin e zbatimit të nenit 35 § 1 të Konventës (shih gjithashtu Williams kundër

tjera, Gjykata e refuzoi argumentin e qeverisë duke ju drejtuar rregullave të saj procedurale, të cilat Gjykata e Lartë shqiptare nuk është e detyruar t'i përfshijë dhe përdorë, megjithatë është me vlerë të përmendet se një element që Gjykata mori në konsideratë ishte arsytimi i Gjykatës së Lartë në Vendimin e Kolegjeve të Bashkuara nr. 6, 11 tetor 2002, ku kjo e fundit u shpreh se një ankimim bazuar në nenin 450 K.Pr.C, përbënte një “mjet të jashtëzakonshëm”.

Bazuar sa më lart, pretenduesit marrin në konsideratë që nuk ka kufizime konceptuale apo ligjore në rendin juridik shqiptar që të ndalojë Gjykatën që pas një vendimi të Gjykatës Europiane në të cilin është konstatuar një shkelje e së drejtës për një gjykim të drejtë, parashikuar në nenin 6, kërkuesi ka të drejtë të dorezojë një kërkesë sipas nenit 450 të Kodit të Procedurës Penale në mënyrë që procesi penal i mbyllur të rihapet dhe çështja e tij të shqyrtohet përsëri (*de novo*). Në këtë drejtim, paditësit theksojnë se Gjykata është e gatshme të pranojë se edhe një praktikë gjyqësore që në pamje të parë nuk duket se përbën një mjet të efektshëm, mundet që me kalimin e kohës dhe akumulimin e jurisprudencës në fund të konsiderohet një mjet efektiv që në parim duhet të ezaurohet²⁰.

Ndoshta çka është më e rëndësishme për qëllimet aktuale, Gjykata vlerësoi në një çështje të mëparshme që edhe pse, duke pasur parasysh rëndësinë e çështjes në fjalë (aborti) për shoqërinë Irlandeze dhe fakti që kuadri ligjor i brendshëm, përfshirë Kushtetutën Irlandeze, vënë theksin në të drejtat e fetusit dhe në kufizimin e rasteve ku aborti mund të lejohet, Gjykata vlerësoi se duke qene se nuk kishte asgjë në formulimin e nenit përkatës në Kushtetutë që do ta privonte veprimin e saj nga mundësia për të rezultuar i suksesshëm, ankimuesi duhet të

Mbretërisë së Bashkuar (vendim nr. 32567/06. 17 shkurt 2009 [...]). Gjykata vë në dukje që rishikimi i një vendimi gjyqësor përfundimtar bazuar në nenin 450 të K.Pr.P përbën një mjet me karakter të jashtëzakonshëm (shih paragrafët 32 e më lart). Në këto rrethana, Gjykata sheh të arsyeshme që ankuesve nuk u kërkohet të ezaurojnë këtë mjet”.

²⁰ Shih Gorou kundër Greqisë (nr.2) [GC], kërkesë Nr. 12686/03, vendimi i 20 mars 2009, paragrafi 32 dhe 34: “Në lidhje me këtë, Gjykata rithekson që i ka kushtuar gjithmonë rëndësi praktikës gjyqësore në kontekst të nenit 6 § 1. Kështu, në jurisprudencën për barazinë e armëve, ka marrë shpesh në konsideratë praktikën gjyqësore në vlerësimin e përputhshmërisë së ligjit vendas me nenin 6 § 1. Këtë e zbatoi veçanërisht në gjykimin e çështjes *Reinhardt and Slimane-Kaïd kundër Francës* (31 mars 1998, § 106, Raporte të Gjykimeve dhe Vendimeve 1998 –II), ku u duk që praktika e dërgimit të shënimeve pranë Gjykatës në diskutime mund të rregullojë paaftësinë e palëve për t’ju përgjigjur parashtrimeve të prokurorit me kusht që ky i fundit të informojë avokatët e palëve mbi përmbajtjen e parashtrimeve të tij përpara ditës së sëancës dëgjimore.[...]. Duke mbajtur parasysh sa më sipër, Gjykata mendon që do të ishte më e ndershme ndaj realitetit të rendit ligjor të brendshëm të merrej në konsideratë kjo praktikë dhe të pranohej që kërkesa e ankimuesit ndaj prokurorit publik është një aspekt logjik i sfidës ndaj vendimit në të cilin pretendimi i saj për kompensim, si palë civile u refuzua. Me fjale të tjera, kërkesa e saj ndaj Prokurorit Publik në Gjykatën e Kasacionit ishte bërë në të njëjtat rrethana dhe synonte të njëjtin qëllim si në kërkesën e mëparshme për të qënë pjesë e procedimit si palë civile.

dorezonte një kërkesë kushtetuese pavarësisht faktit që jurisprudenca e brendshme, doktrina ligjore dhe tradita e vështirësonin arritjen e një rezultati të sukseshëm²¹.

Gjykata e Lartë shqiptare duhet të ketë në konsideratë faktin që për shkak të krizës politike në Shqipëri, ka pak të ngjarë që këto amendime të K.Pr.P të prezantohen brenda një periudhe të shkurtër kohore. Ndërkohë që, numri i çështjeve të lëna pezull përpara Komitetit të Ministrave dhe që ngrenë problematika të ngjashme me ato të përmendura në parashtrimin aktual, është në rritje. Kështu përveç çështjes Laska/Lika, aktualisht janë edhe katër çështje të tjera të ngjashme përpara Komitetit të Ministrave (*Xheraj kundër Shqipërisë*, nr. 37959/02, *Caka kundër Shqipërisë*, nr. 44023/02, *Berhani kundër Shqipërisë*, nr. 847/05 and *Shkalla kundër Shqipërisë*, nr. 26866/05), ndërkohë që raste të tjera mund të paraqiten në të ardhmen. Për këtë arsye, çdo vonesë në paraqitjen e amendimeve përkatëse do të ketë një ndikim negativ në një numër në rritje individësh (kështu p.sh, kërkuesit në çështjen Caka dhe Berhani janë ende duke vuajtur dënimet e tyre ndërkohë që kërkuesit në çështjen Xheraj, Laska dhe Lika nuk do të jenë në gjendje p.sh., të kenë një dosje penale të pastër në mënyrë që të kenë mundësi të kërkojnë të punësohen dhe të riintegrohen në shoqëri) gjë që mund ta shtyjë Komitetin e Ministrave të marrë masa kundër Shqipërisë, si për shembull dhënia e një rekomandimi me tone të ashpra, si në rastin e Turqisë²².

Rishikimi i vendimeve penale përfundimtare pas konstatimit të shkeljes konventore nuk e destabilizon sistemin e drejtësisë dhe rendin juridik. Nga natyra e gjërave, rishikimi postkonventor nuk ka karakter automatik, por varet nga shkalla dhe natyra e shkeljeve, të cilat janë procedurale. Ashtu si në procedurën penale shqiptare jo çdo shkelje procedurale sjell prishjen e vendimit; po kështu jo çdo shkelje e konstatuar nga GJEDNJ mund të çojë në prishjen e vendimeve përfundimtare ose në pafajësinë apo uljen e dënimit të ankuesve.

²¹ Vendimi *D. kundër Irlandës*, kërkesë nr. 26499/02, paragrafi 92 dhe 102: “Gjykata konstaton se, nëse neni 40.3.3 përjashtonte abortin në rastin e një anomalie fatale të fetusit kjo do të ishte një çështje e re, e megjithatë do të përbënte një argument të diskutueshëm i cili do të paraqiste shumë mundësi për të qenë i suksesshëm në lejimin e barrës fillestare mbi Qeverinë që të konsiderohej e kënaqur. Kështu, më 25 janar 2002, një mjet juridik kushtetues ishte në parim në dispozicion të ankimuesit për të marrë urdhra të detyrueshëm dhe deklarativ me qëllimin për të realizuar mundësinë e një aborti të ligjshëm në Irlandë [...]. Për ta përmbledhur, Gjykata konstaton që parimisht ka një mjet kushtetues në dispozicion të ankimuesit, por ka disa pasiguri që i ngarkohen tre çështjeve që rrjedhin nga novacioni i çështjes themelore dhe nga detyrimet procedurale të pozicionit të ankimuesit – mundësitë për sukses, koha e procedimit, dhe garantimi i konfidencialitetit mbi identitetin e ankimuesit”.

²²Shih Rezoluten Interim CM/ResDH (2007) 150 mbi ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut Hulki Güneş kundër Turqisë, mund ta gjeni në [https://wcd.coe.int/wcd/ViewDoc.jsp?Ref=CM/ResDH\(2007\)150&Language=lanEnglish&Ver=original&Site=CM&BackColorInternet=9999CC&BackColorIntranet=FFBB55&BackColorLogged=FFAC75](https://wcd.coe.int/wcd/ViewDoc.jsp?Ref=CM/ResDH(2007)150&Language=lanEnglish&Ver=original&Site=CM&BackColorInternet=9999CC&BackColorIntranet=FFBB55&BackColorLogged=FFAC75)

Gjykata e Lartë, nëpërmjet kolegjit seleksionues, mund të pranojë për rishikim vetëm:

- a) ato shkelje që janë serioze deri në atë pikë sa krijojnë dyshime serioze për padrejtësinë dhe pabazueshmërinë e vendimit dhe
- b) ato shkelje që kanë pasoja mjaft të rënda për ankuesin që nuk mund të riparohen vetëm nëpërmjet kompensimit monetar.

Kështu, p.sh. konstatimi nga GJEDNJ i shkeljes së nenit 6 § 1 të Konventës për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm nuk e prek themelin e vendimit të atakuar, kurse mungesa e mbrojtjes, e barazisë së armëve etj., duhet të çojë në rishikimin e procesit, rezultati i të cilit do të varet nga rrethanat konkrete.

Në çështjen konkrete Laska e Lika kundër Shqipërisë, shkeljet e konstatuara nga Gjykata Europiane e të Dretjave të Njeriut në procesin e zhvilluar kundër tyre janë serioze, sepse fajësia dhe dënimi i tyre u bazuan kryesisht në një “provë” të marrë në mënyrë arbitrare dhe në shkelje flagrante të dispozitave të KPP. Ky është një shkak serioz për rishikimin e vendimeve përfundimtare të dhëna kundër tyre.

Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Soros dhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Përgatur nga:

Kristaq Traja, avokat

Theodoros Alexandridis, avokat